# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 262

**Tiranë – E martë, 10 janar 2017**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim"........ | 27197 |

**VENDIM**
**Nr. 943, datë 28.12.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.759, DATË 12.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LICENCIMIN PROFESIONAL TË INDIVIDËVE DHE PERSONAVE JURIDIKË QË DO TË USHTROJNË VEPRIMTARI NË FUSHËN E STUDIMIT E TË PROJEKTIMIT NË NDËRTIM DHE MBIKËQYRJES E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1, e vendimit, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Çdo individ apo person juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse dhe të regjistrohet në regjistrat profesionalë të subjekteve të licencuara në këto fusha, bazuar në rregulloren bashkëlidhur këtij vendimi.".

2. Pas nënndarjes së gjashtë, të pikës 2, shtohen nënndarjet dhe paragrafi, si më poshtë vijon:

"- një përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë;

- një përfaqësues nga Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë;

- një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;

- një përfaqësues nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.

Anëtarët e komisionit shpërblehen për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në komision sipas akteve nënligjore në fuqi, që përcaktojnë masën e shpërblimit për anëtarët e këshillave, të bordeve apo komisioneve në njësitë e qeverisjes qendrore.".

3. Rregullorja që i bashkëlidhet vendimit nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**RREGULLORE**
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE PËR INDIVIDË DHE PERSONA JURIDIKË NË FUSHËN E STUDIMIT E TË PROJEKTIMIT NË NDËRTIM DHE MBIKËQYRJE E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMITNË NDËRTIM

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit.**

Kjo rregullore përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:

1. Organizimin dhe funksionimin e strukturave, që kryejnë dhe mbështesin procesin e licencimit profesional të subjekteve, në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

2. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, kushtet dhe kriteret paraprake, dokumentare dhe specifike, që duhen plotësuar për t'u pajisur me licencë profesionale.

3. Të drejtat që kanë subjektet për t'u pajisur me licencë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit.

4. Detyrimet dhe kufizimet që kanë subjektet, si dhe masat administrative, për rastet e veprimeve në kundërshtim me dispozitat në fuqi, gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Neni 2
**Përkufizimi i termave**

1. "Komision" - Është struktura e posaçme administrative , që funksionon pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, që ka autoritetin e vetëm, për dhënien apo heqjen e licencave, për subjektet që ushtrojnë veprimtari, në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

2. "Licencë profesionale" - Është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën, të fillojë e të ushtrojë profesionalisht veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, ose mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

3. "Vite eksperience profesionale" - Vite ushtrimi aktiviteti profesional në fushat respektive, e dokumentuar me referenca apo dokumente ekuivalente, të lëshuara nga persona juridikë publik apo privat, apo persona fizikë, nga momenti i diplomimit në nivelet e përcaktuara, në kriteret specifike të kësaj rregulloreje).

4. "Kategori" – Specifikimi i llojit apo nënllojit të veprimtarisë, në fushën e studimit, projektimit, mbikëqyrjes e kolaudimit.

5. "Subjekt" – Në kuptim të kësaj rregulloreje, është çdo person fizik ose juridik, që ushtron veprimtari në fushën e studimit, projektimit, mbikëqyrjes e kolaudimit.

6. "Shoqëri/studio"- Personi juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar (pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit), sipas legjislacionit në fuqi, për ushtrimin e veprimtarisë profesionale të studimit e projektimit dhe/ose mbikëqyrjes e kolaudimit në fushën e ndërtimit.

7. "Sekretariati Teknik i Komisionit" - është struktura përkatëse pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, që kryen procedurat administrative të trajtimit, vlerësimit, relatimit dhe regjistrimit të individëve dhe personave juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e studimit e projektimit dhe/ose mbikëqyrjes e kolaudimit.

KREU II
FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE

KOMISIONI I POSAÇËM PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE

Neni 3
**Krijimi – përbërja**

1. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me këtë rregullore dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kritere në këtë fushë.

2. Komisioni merr vendime për dhënie licence profesionale individuale dhe për shoqëri, shtesa dhe rinovime në licencat profesionale, ndryshime të drejtuesve të shoqërisë dhe marrjen e masave administrative, mbështetur kryesisht në kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 4
**Komisioni i licencimit**

1. Komisioni thirret në mbledhje nga Kryetari i tij.

- Si rregull, ai mblidhet çdo muaj, ndërmjet datave 25 – 30.
- Me kërkesë të Kryetarit të Komisionit mblidhet dhe jashtë radhë.

2. Në mbledhjen e tij të parë, Komisioni zgjedh Nënkryetarin e tij.

3. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në mungesë të Kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga Nënkryetari i Komisionit.

4. Në mbledhje, Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, informacionet e paraqitura nga Sekretariati Teknik, të cilat janë depozituar, të paktën 4 ditë, para datës së mbledhjes.

5. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll. Protokolli mbahet nga një përfaqësues i Sekretariatit Teknik të Komisionit ose përfaqësues i Drejtorisë përgjegjëse për licencimin. Protokolli mbahet në një libër të veçantë protokolli, të sekretuar me numër faqesh dhe përmban të dhëna, të paktën, për pjesëmarrjen, diskutimet, votimin dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve.

6. Kryetari i Komisionit vendos për praktikat e përgatitura nga Sekretariati Teknik, që lidhen me kërkesa të subjekteve të karakterit formal, si vijon;

- Ndryshim dhe shtesë në përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë;
- Ndryshim emërtim shoqërie;
- Ndryshimi i selisë së shoqërisë;
- Lëshimi i dublikatës;
- Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrim i tyre.

Neni 5
**Përgatitja e materialeve për Komision**

1. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës të Komisionit hartohet nga Sekretariati Teknik dhe miratohet nga Kryetari i Komisionit.
2. Komisioni shqyrton materiale, që kanë të bëjnë me licencimin e individëve apo shoqërive, ankesa të tyre për vendimet pararendëse, informacione e kërkesa të personave juridikë publik apo privat, përfundime dhe raporte nga kontrollet e kryera.
3. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen anëtarëve të Komisionit nga Sekretariati Teknik, jo më vonë se tre ditë para ditës së caktuar për mbledhje.
4. Materialet përgatiten nga Sekretariati Teknik dhe nënshkruhen nga drejtuesi respektiv dhe përpunuesit e tij.

Neni 6
**Ekspertët**

1. Për çështje që do të shqyrtohen, të cilat kanë nevojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm, caktohen ekspertë. Çdo grup ekspertësh drejtohet nga një anëtar Komisioni.
2. Ekspertët përzgjidhen nga drejtori i strukturës përgjegjëse për licencimin pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, në bashkëpunim me shoqatat që zhvillojnë aktivitet në fushën përkatëse dhe hartojnë ekspertizën e tyre pa shpërblim.
3. Ekspertiza e përgatitur me shkrim i dorëzohet Komisionit, nëpërmjet Sekretariatit Teknik.

Neni 7
**Afati i marrjes së vendimeve**

Komisioni merr vendim jo më vonë se 35 ditë kalendarike, nga momenti i aplikimit me dokumentacion të plotë.

Neni 8
**Marrja dhe hartimi vendimeve**

1. Vendimet në Komision, si rregull, merren me konsensus. Kur konsensusi nuk arrihet, vendimi merret me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve pjesëmarrës. Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.
2. Vendimet e Komisionit hartohen nën përgjegjësinë e Sekretariatit Teknik, dhe nënshkruhen nga Kryetari dhe anëtarët e Komisionit, që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.
3. Vendimet e Komisionit përgatiten në tre kopje: njëra dorëzohet në zyrën e arkiv dokumentacionit të Ministrisë, tjetra në Sekretariatin Teknik, për veprime të mëtejshme, dhe e treta në praktikën e Komisionit, që disponohet nga Kryetari i Komisionit.

SEKRETARIATI TEKNIK

Neni 9
**Organizimi**

Sekretariati Teknik i Komisionit organizohet dhe funksionon pranë Drejtorisë përgjegjëse për licencimin, në Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Organizimi i Sekretariatit bëhet në bazë e zbatim të strukturës organizative të Ministrisë dhe veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me rregulloren e brendshme të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe këtë rregullore.

Neni 10
**Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave**

1. Kërkesa për licencë, si dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë:

a) origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit;

b) në gjuhën shqipe, ose të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të

vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre, si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili disponohet në listën e publikuar të dokumentacionit të kërkuar. Tarifat për individë dhe personat juridikë, vendas e të huaj, që licencohen, janë sipas Lidhjes nr.1, të kësaj rregulloreje.

4. Sekretariatit Teknik regjistron menjëherë në protokollin e aplikimeve kërkesat e regjistruara elektronikisht dhe përgatit kartelën shoqëruese të aplikimit.

5. Në kartelën shoqëruese evidentohen shënime, në lidhje me përputhshmërinë e dokumentacionit të aplikimit, me kërkesat e kësaj rregulloreje. Kartela shoqërohet detyrimisht me mendimin e motivuar e të nënshkruar të specialistit dhe përgjegjësit të sektorit. Mendimi i Sekretariatit, në materialin që i paraqitet Komisionit, bazohet në këtë kartelë.

6. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve, pranë Sekretariatit Teknik, do të kryhet vetëm në këto raste:

a) Për dorëzimin e fotografive të individit që aplikon, të cilat dorëzohen fizikisht nga aplikuesi, deri në momentin e tërheqjes së formularit të licencës;

b) Për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë rregullore;

c) Kur kërkohet verifikim i dokumentit/ dokumenteve nga Sekretariati Teknik;

ç) Kur kërkohet verifikim nga Komisioni i Posaçëm.

7. Çdo dokumentacion aplikimi apo plotësime të tij, shqyrtohet brenda 2 ditë pune, nëse përmban ose jo, të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës, sipas kësaj rregulloreje, duke njoftuar aplikuesin, nëpërmjet sistemit informatik.

Neni 11
**Verifikimi i dokumentacionit**

1. Verifikimi i deklarimeve apo dokumenteve të subjekteve aplikuese kryhet në bazë të informacioneve që disponohen nga subjekte juridikë publik apo privat, ose me përzgjedhje nga Sekretariati Teknik, pranë institucioneve kompetente.

2. Procedurat dhe afatet e verifikimit nuk pengojnë procesin e licencimit të subjekteve.

3. Në rastet e konstatimit të deklarimeve apo dokumenteve të rreme, atëherë Sekretariati Teknik relaton këtë fakt pranë Komisionit dhe propozon masat konkrete, në përputhje me nenin 41 të rregullores.

Neni 12
**Ruajtja dhe arkivimi**

1. Sekretariati Teknik, mbi bazën e vendimit të Komisionit, përgatit formularët e licencave në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave, pas nënshkrimit nga Kryetari, i dorëzohet subjektit përkatës, e vulosur, ndërsa tjetra, e nënshkruar edhe nga hartuesit, ruhet për arkivim.

2. Licencat profesionale janë dokumente me vlerë, që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm dhe kontrollit të rreptë.

Formati i tyre miratohet nga Ministri i Zhvillimit Urban.

3. Sekretariati Teknik përgjigjet për arkivimin, sipas rregullave në fuqi, të licencës dhe kartelës shoqëruese të aplikimit.

4. Arkivimi i këtij dokumentacioni organizohet, sipas rregullave të brendshme të Ministrisë së Zhvillimit Urban, në ambient të veçantë.

Neni 13
**Bashkëpunimi me persona juridik publik apo privat**

1. Sekretariati Teknik, nëpërmjet strukturës organizative të Ministrisë së Zhvillimit Urban, mban lidhje të qëndrueshme me institucionet e administratës shtetërore. Ai:

a) kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për subjektet që licencohen pranë tij;

b) trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave apo propozimeve të tyre;

c) kërkon me shkresë zyrtare, verifikimin e saktësisë së vetëdeklarimeve të aplikuesve, apo vërtetësisë së dokumenteve të lëshuara nga institucionet, e të paraqitura nga subjektet në procedurat e aplikimit.

2. Sekretariati Teknik ka për detyrë të informojë çdo kërkues, në lidhje me:

a) kërkesat e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për të aplikuar për licencë;

b) përputhshmërinë e dokumentacionit në lidhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

c) ecurinë e aplikimit të tij për licencë;

ç) të dhëna në lidhje me individë, apo shoqëri të licencuara, për rastet kur kërkuesi vërteton se është i përfshirë në procese ligjore, me subjektin, për të cilin kërkon informacion.

3. Sekretariati Teknik, si rrjedhim i kërkesës së Komisionit, apo i procesit të përzgjedhjes të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve/ dokumenteve, kërkon me shkresë zyrtare, pranë subjekteve private, informacione në lidhje me vërtetësinë e:

a) referencave të lëshuara nga subjekti privat, të paraqitura nga aplikuesi.

b) projekteve të hartuara nga subjekte udhëheqës të këtyre projekteve, e të paraqitura nga aplikuesi, si bashkëpjesëmarrës në hartimin e tyre.

Neni 14

**Veprime drejtpërdrejtë nga Sekretariati Teknik pa pasur nevojë për t'u trajtuar me mbledhje në Komision**

1. Sekretariati Teknik ka të drejtë të kryejë çdo ditë veprime, pa kaluar në trajtimin nga Komisioni, për rastet e parashikuara në nenin 4, pika 6 të kësaj rregulloreje, mbështetur në dokumenta-cionin përkatës të paraqitur, në zbatim të kësaj rregulloreje.

2. Për çdo rast të tillë paraqitet kërkesa, nëpërmjet sistemit informatik të integruar dhe veprohet sipas nenit 10 të Rregullores.

3. Vlerësimi i dokumentacionit, të paraqitur sipas pikës 1, shoqërohet me procesverbal të hartuar nga Sekretariati Teknik, i cili së bashku me licencat respektive, që pasqyrojnë ndryshimin (për rastet kur nevojitet licencë e ndryshuar), i dërgohen për nënshkrim Kryetarit të Komisionit. Ndryshimet reflektohen menjëherë në regjistrat profesionalë të subjekteve të licencuara. Sekretariati Teknik bën të pavlefshme licencën profesionale origjinale, që subjekti disponсовнte përpara ndryshimit.

Neni 15

**Regjistrat profesionalë dhe Arkivi**

1. Sekretariati Teknik është përgjegjës për hartimin, përditësimin dhe publikimin në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Zhvillimit Urban, e:

a) Regjistrit profesional për licencat profesionale individuale për studim e projektim;

b) Regjistrit profesional për licencat profesionale të shoqërive për studim e projektim;

c) Regjistrit profesional për licencat profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim;

ç) Regjistrit profesional për licencat profesionale të shoqërive për mbikëqyrje e kolaudim.

2. Arkivi i dokumentacionit fizik të aplikimeve dhe licencave të miratuara, organizohet nga Sekretariati Teknik, sipas përcaktimeve në ligjin për arkivat, bashkë ose veças nga arkivi i Ministrisë, në bazë të Urdhrit të veçantë të Titullarit.

KREU III
LICENCAT PROFESIONALE – KATEGORITË, ELEMENTËT DHE KUFIZIME

Neni 16

**Licenca – kategoritë e punimeve**

1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.

2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kritereve të specifikuara në këtë rregullore.

3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.

Neni 17
**Llojet e licencave dhe elementët e saj**

1. Llojet e licencave janë:
a) Licencë profesionale individuale;
b) Licencë profesionale për shoqëri.
2. Licencat profesionale personale, apo për shoqëri, jepen për këto veprimtari:
a) Studim e projektim në ndërtim;
b) Mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi në ndërtim.
3. Licenca përmban këta elemente:
a) Të dhëna të individit apo shoqërisë disponuese;
b) Titullin e diplomës së individit dhe vitin e diplomimit, për licencat individuale.
c) Datën e regjistrimit në regjistrat profesional përkatës.
ç) Kategoritë për veprimtaritë që ka të drejtë të ushtrojë disponuesi;
d) Afati i vlefshmërisë për rastet e shoqërive;
dh) Numrin unik të licencës profesionale;
e) Shenja dalluese;
ë) Fotografia e individit për licencat individuale;
f) Kategoritë e plota në fushën e studimit e projektimit (për licencat e studimit e projektimit) dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit (për licencat e mbikëqyrjes e kolaudimit), në pjesën e prapme të formularit të licencës.

Neni 18
**Kufizime për tërheqjen dhe përdorimin e licencave**

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo trashëgohet, nga një individ apo shoqëri tek tjetra.
2. Kur një individ apo shoqëri humbet licencën profesionale, njofton menjëherë, zyrtarisht, Sekretariatin Teknik.
3. Licencat individuale tërhiqen nga vetë personi i licencuar, ose nga persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet).
4. Licencat e shoqërive tërhiqen nga përfaqësuesi ligjor, ose persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet), ose nga drejtuesit teknikë të shoqërisë.
5. Shoqëritë që janë pajisur me licencë të re, si rezultat i ndryshimit të drejtuesve teknikë, përfaqësuesve ligjorë, apo ndryshim të emrit apo selisë, përpara se të tërheqin licencën, duhet të dorëzojnë origjinalin e licencës paraardhëse. Origjinali shënjohet nga Sekretariati Teknik me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit, pranë arkivës së Sekretariatit.
6. Personat të cilët janë të pajisur me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, të cilët punësohen pranë shoqërive për zbatim të punimeve të ndërtimit, duhet të dorëzojnë kopjen origjinale të licencës së mbikëqyrjes dhe kolaudimit, pranë arkivës së Sekretaritit Teknik. Kjo licencë i kthehet përsëri personit, në momentin që ai shkëputet nga pozicioni i drejtuesit teknik, në shoqërinë për zbatimin në ndërtim.

Neni 19
**Kufizime në dhënien e licencave**

1. Nuk lejohet të pajisen me licencë, në rolin e drejtuesit teknik për shoqëri, personat që punojnë në institucionet shtetërore qendrore, vendore, apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil.
2. Shoqëritë për zbatim të punimeve të ndërtimit, drejtuesit teknikë të tyre dhe specialistët e licencuar, që punojnë pranë tyre, nuk mund të licencohen si individë e shoqëri për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim.

Neni 20
**Afatet e vlefshmërisë së Licencës**

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave, nga data e lëshimit të tyre, janë:
a) për licencë profesionale të shoqërive për studim e projektim, sa afati i vlefshmërisë së kontratës, që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknikë (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të shkurtër), por jo më shumë se 5 vjet.
b) për licencë profesionale të shoqërive për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim, sa afati i vlefshmërisë së kontratës, që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknikë (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të shkurtër), por jo më shumë se 5 vjet.
c) licencat individuale jepen me afat të përhershëm.

2. Afati kohor minimal, për të kërkuar shtesë të kategorive në licencën profesionale individuale dhe të shoqërive, është jo më pak se një vit. Nuk zbatohet ky afat, në rastin e përfitimit të kategorive shtesë, si rrjedhim i ndryshimit apo shtesës së drejtuesve teknikë në shoqëri.

KREU IV
KUSHTET PARAPRAKE PËR TË FITUAR LICENCË, DETYRAT DHE TË DREJTAT E SUBJEKTEVE QË LICENCOHEN

Neni 21
**E drejta për pajisje me licencë**

1. Çdo individ apo shoqëri, vendas ose i huaj, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Komisionit të Posaçëm të dhënies së licencave profesionale, për t'u pajisur me licencë profesionale, pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë rregullore.

2. Kushtet dhe kriteret specifike, të cilat kërkohen në përgjithësi, për të fituar kategoritë e veprimtarisë në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, jepen në vijim të kësaj rregulloreje dhe në lidhjet nr.4 dhe nr.5 të rregullores.

Neni 22
**Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale**

Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale, janë:

1. Për studim e projektim.

a) Të disponojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilet përkatëse, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;

b) Të ketë vite eksperiencë në projektim, në institucione publike projektuese, shoqëri studimi e projektimi, persona fizikë që ushtrojnë veprimtari profesionale në studim e projektim, ose institucione të arsimit të lartë.

2. Për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim

a) Të disponojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë, në profilet përkatëse, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;

b) Të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë në studime e projektime, apo zbatimin në ndërtim, në profesionin përkatës;

c) Të mos jetë drejtues teknik ose i punësuar, në shoqëri për zbatimin në ndërtim.

Kushtet e mësipërme paraprake, vlejnë dhe për individët e huaj, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale.

Neni 23
**Kushtet paraprake për drejtuesit teknikë të shoqërisë**

1. Kushtet paraprake për të pasur pozicionin e drejtuesit teknik të shoqërisë, janë:

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë për studime e projektime, është një, ose më shumë individë, të cilët disponojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë, të jetë pajisur me licencë profesionale individuale dhe të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë. Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin, rezulton 9 ose më shumë, mund të regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vite eksperiencë. Individi mund të përfitojë licencën individuale, njëkohësisht, me vendosjen si drejtues teknik.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim, është një, ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale në fushën respektive dhe me vite eksperience, jo më pak se 15 vjet. Individi mund të përfitojë licencën individuale, njëkohësisht, me vendosjen si drejtues teknik.

c) Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

ç) Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi, në dy ose më shumë shoqëri.

d) Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë, për një periudhë, jo më pak se një vit.

dh) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë, përcaktohen në kontratën e punës të lidhur midis tyre.

2. Në rastet e shoqërive të huaja, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte dhe kritere paraprake si më sipër.

a) Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së huaj është vendas, zbatohen të njëjtat kushte paraprake, si për drejtuesin teknik në rastin e shoqërive vendase.

b) Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së huaj, është i huaj, bëhet ekuivalentimi i licencës individuale të tij, sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe gjithashtu, zbatohen të njëjtat kushte paraprake, si për shoqëritë vendase.

Neni 24

**Kushtet paraprake për licencë profesionale shoqërie**

Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëri/studio, janë:

1. Për studimin e projektimin:

a) Të jenë regjistruar si person juridik, sipas dispozitave ligjore, për të ushtruar veprimtari në studim e projektim;

b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për studim e projektim;

c) Të mos kenë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi.

2. Për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi:

a) Të jenë regjistruar si person juridik, sipas dispozitave ligjore, për të ushtruar veprimtari në mbikëqyrje e kolaudim;

b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim;

c) Të mos kenë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi.

Në rastet e shoqërive të huaja, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte paraprake si shoqëritë vendase.

Neni 25

**Detyrat e subjekteve të licencuara**

1. Detyrat e subjekteve të licencuara, janë:

a) Të njohin dhe të kryejnë veprimtari, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit.

b) Të njohin e të zbatojnë standardet, kushtet teknike të projektimit, si dhe normat e standardet europiane të pranuara nga vendi ynë.

c) Çdo subjekt i licencuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të drejtuesit/drejtuesve teknikë.

ç) Subjekti duhet të kenë statusin "aktiv" të ushtrimit të veprimtarisë, dëshmuar me dokumentin respektiv (ekstrakti historik apo ekstrakti për të dhënat e subjektit), të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ose vendimin e gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.

d) Drejtuesi teknik i shoqërisë detyrohet të njoftojë një muaj më parë, zyrtarisht, me kërkesë të motivuar, përfaqësuesin ligjor për largimin nga shoqëria. Njëkohësisht, duhet të paraqesë pranë Komisionit të Posaçëm, kërkesën/deklaratën për prishjen e kontratës, të hartuar në prani të noterit, ose dokumentin zyrtar, të lëshuar nga shoqëria për këtë largim.

dh) Çdo largim, pa respektuar procedurat e pikës "e" të këtij neni, shoqërohet me marrjen e masës administrative kundrejt individit.

e) Çdo ushtrim veprimtarie nga shoqëria, pa drejtues teknik, shoqërohet me masë administrative kundrejt shoqërisë, sipas përcaktimeve të nenit 41 të kësaj rregulloreje.

KREU V

KUSHTET DOKUMENTARE PËR PAJISJEN ME LICENCË PROFESIONALE DHE REGJISTRIMI PROFESIONAL

Neni 26

**Për pajisje me licencë profesionale individuale për herë të parë**

1. Aplikimi për pajisje me licencë individuale për herë të parë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen të paktën gjeneralitetet, adresa e plotë e individit

dhe kategoritë, sipas zërave të punimeve, me të cilat individi kërkon të licencohet;

b) Kartën e identitetit;

c) Diplomën që zotëron;

ç) CV e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës ;

d) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën.

dh) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6).

e) Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/2 të lidhjes nr.6).

ë) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 27

**Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale**

Aplikimi për pajisje me shtesa në licencën individuale ekzistuese, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen dhe kategoritë sipas zërave të punimeve, të cilat individi kërkon të shtohen në licencën, që disponon nga një aplikim i mëparshëm;

b) kartën e identitetit;

c) CV e aplikantit, ku të pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga aplikimi paraardhës;

ç) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

d) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit(sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

dh) Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/2 të lidhjes nr.6).

e) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

ë) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 28

**Për dublikatë të licencës individuale**

Aplikimi për pajisjen me dublikatë të licencës individuale, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet, dhe arsyet e kërkesës;

b) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik në këtë fushë (sipas formatit 6/3 të lidhjes nr.6);

c) Në rastet kur personi kërkon të dublojë licencën për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/4 të lidhjes nr.6);

ç) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit);

d) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 29

**Për rinovimin e kategorive te licencës individuale**

Aplikimi për rinovimin e kategorive të licencës individuale, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesën e individit, ku të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të rinovohet;

b) Kartën e identitetit;

c)Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik në këtë fushë (sipas formatit 6/3 të lidhjes nr.6);

ç) Në rastet kur personi kërkon të rinovojë licencën për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm edhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/4 të lidhjes nr.6);

d) Veprimtaria e tij e kryer nga aplikimi paraardhës në formën e CV;

dh) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin, apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

e) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit);

ë) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 30

**Për ekuivalentimin e licencës profesionale për individë që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës (jo Shqipëri)**

Aplikimi për ekuivalentim të licencës profesionale individuale, që individë kanë përfituar në vende të huaja, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesë e individit, ku të përcaktohen të paktën gjeneralitetet, adresa e plotë e individit dhe kategoritë sipas zërave të punimeve, me të cilat individi kërkon të licencohet dhe ato, që ai mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;

b) Dokumentin e identitetit që disponon;

c) Diplomën që disponon në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;

ç) Licencën (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv), që disponon në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;

d) Veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës në formën e CV;

dh) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo

organizma; projekte (ose pjesë të tyre), ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin, apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

e) Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

ë) Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm edhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/2 të lidhjes nr.6);

f) Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit);

g) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 31

**Për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë**

Aplikimi për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet, të paktën, emërtimi, rezidenca, adresa e plotë, përfaqësuesit ligjorë e drejtuesit teknikë të shoqërisë;

b) Ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi), me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, veprimtaria dhe statusi aktiv i shoqërisë/ose vendimin e gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.

c) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

ç) Kontratë midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);

d) Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

i) mbi gjendjen e tij, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii) për gjendjen, në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5 të lidhjes nr.6).

dh) Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë, për individin që kërkon të regjistrohet drejtues teknik, rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vite eksperiencë, paraqitet edhe lista e notave;

e) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;

ë) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1)

*Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht, pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.*

Neni 32

**Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë**

Aplikimi për pajisje me shtesa të kategorive në licencën ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknik të shoqërisë), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën, kategoritë që kërkohen të shtohen;

b) Kontratat midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;

c) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

ç) Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

i) mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;

ii) për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik, në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5 të lidhjes nr.6);

d) Vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen nga shoqëria të të gjitha detyrimeve tatimore;

dh) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

*Drejtuesi teknik plotëson dokumentacionin për shtesa në licencën e tij individuale (të cilat i kalojnë automatikisht shoqërisë), sipas kërkesave të nenit 27 të kësaj rregulloreje, përjashtuar vetëdeklarimin, i cili duhet të hartohet sipas kërkesës së këtij neni.*

Neni 33

**Për zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë apo dublikatë**

Aplikimi për zgjatjen e afatit të licencës ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknikë të shoqërisë, apo rinovim të kategorive në kuptim të nenit 43), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, që kërkon zgjatje të afatit të licencës apo dublikatë. Për rastet kur kërkohet dublikatë, të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet dhe arsyet e kërkesës për dublikatë;

b) Kontratat midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;

c) Vetëdeklarim i përfaqësuesve ligjorë, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilicencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik në këtë fushë (sipas formatit 6/3 të lidhjes nr.6);

ç) Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

i) mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii) për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik.

(sipas formatit 6/5 të lidhjes nr.6)

d) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;

dh) Dokument që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 34

**Për rinovimin e kategorive te licencës së shoqërisë**

Aplikimi për rinovimin e kategorive te licencës së shoqërisë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohen, të paktën, të dhënat e licencës së disponuar më parë;

b) Veprimtaria e shoqërisë, e kryer nga aplikimi paraardhës, në formën e CV;

c) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer nga

shoqëria në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet; projekte (ose pjesë të tyre). Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin, apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

ç) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilicencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit në këtë fushë (sipas formatit 6/3 të lidhjes nr.6);

d) Kontratat midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë;

dh) Vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;

e) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

*Ky aplikim, shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 29 të kësaj rregulloreje (Për rinovimin e kategorive te licencës individuale), për drejtuesit teknikë, për të cilët kërkohet rinovimi i kategorive, e për rrjedhim të tij, shoqëria përfiton rinovim.*

Neni 35

**Për ndryshim ose shtesë të përfaqësuesit ligjor**

Aplikimi për ndryshimin e përfaqësuesit ligjor apo shtesë të tij, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesën e përfaqësuesit ligjor të ri të shoqërisë, ku të përcaktohen, të paktën, të dhënat e licencës së disponuar më parë;

b) Ekstraktin historik të subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi), me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, ndryshimi i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë, veprimtaria dhe statusi aktiv i shoqërisë/ose vendimin e gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.

c) Vetëdeklarim i përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë të rinj, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, në lidhje me fushën ku është licencuar dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

ç) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;

d) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1)

Neni 36

**Për ndryshim ose shtesa të drejtuesit/drejtuesve teknikë**

Aplikimi për ndryshim ose shtesa të drejtuesit teknik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesën e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohen, të paktën, të dhënat e licencës së disponuar më parë, drejtuesit teknikë që do të largohen dhe ata që do të shtohen;

b) Vetëdeklarimin e përfaqësuesit ligjor, për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, në lidhje me fushën ku është licencuar dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

c) Kontratat midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë të rinj, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);

ç) Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

i) mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii) për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5 të lidhjes nr.6);

d) Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin, që kërkon të regjistrohet drejtues teknik, rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vite eksperiencë, paraqitet edhe lista e notave;

dh) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

*Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht, pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.*

Neni 37

**Për ndryshim emërtim dhe/ose seli shoqërie**

Aplikimi për ndryshim të emërtimit të shoqërisë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake, të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Ekstraktin historik të subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi), me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, ndryshimi i emërtimit të shoqërisë, veprimtaria dhe statusi aktiv i shoqërisë/ose vendimin e gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.

b) Vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore.

c) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

Neni 38

**Për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës**

Aplikimi për ekuivalentim të licencës profesionale, që shoqëritë kanë përfituar në vende të huaja, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake, të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

a) Kërkesë, ku të përcaktohen të paktën të dhënat e shoqërisë në lidhje me emërtimin, përfaqësuesit ligjorë e teknikë të saj, rezidencën, adresën e plotë dhe kategoritë sipas zërave të punimeve, me të cilat shoqëria kërkon të licencohet dhe ato, që mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;

b) Ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi), me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, lidhja e shoqërisë së krijuar e që kërkon të licencohet, me atë të vendit të origjinës, që disponon licencë profesionale, veprimtaria dhe statusi aktiv i shoqërisë;

c) Vetëdeklarimin e përfaqësuesit/ përfaqësuesve ligjorë, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin që të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);

ç) Kontratën midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të përkthyer e të noterizuar, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);

d) Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

i) mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;

ii) për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

iii) për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5 të lidhjes nr.6).

dh) Licencën (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv), që disponon shoqëria dhe drejtuesit teknikë të shoqërisë në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;

e) Diplomën që disponon drejtuesi/drejtuesit teknikë të shoqërisë në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;

ë) Veprimtaria e kryer nga shoqëria nga marrja e licencës në vendin e origjinës, në formën e CV;

f) Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV: vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre); certifikata

vlerësimi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;

g) Vërtetim nga organet tatimore, për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;

gj) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr.1).

*Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë, që shtohen në shoqëri, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht, pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.*

Neni 39

**Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë**

Aplikimi për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë, në lidhje me fushën e studimit e projektimit apo/edhe mbikëqyrjes e kolaudimit, shoqërohet me:

a) Njoftimin e përfaqësuesit ligjor, për mbylljen e aktivitetit;

b) Dorëzimin e licencës/licencave origjinale, që disponon.

Neni 40

**Regjistrimi i licencave profesionale**

1. Të dhënat e licencave profesionale që miratohen nga Komisioni, regjistrohen në Regjistrat profesionalë të licencave profesionale individuale dhe të shoqërive.

2. Regjistrat profesionalë janë dokumente elektronikë, në përgjegjësi të Sekretariatit Teknik, ku regjistrohen të dhënat e licencimit të subjekteve, sa herë ato trajtohen dhe u miratohet licencimi, me të paktën parametrat:

- Emërtimi i subjektit të licencuar
- Numri unik i licencës profesionale
- Rezidenca e subjektit
- Emri i përfaqësuesit ligjor në rastin e shoqërive
- Afati i vlefshmërisë në rastin e shoqërive.

3. Të dhënat përditësohen, në përputhje me ndryshimet që licencat pësojnë, si rezultat i aplikimeve, miratimeve apo masave administrative.

4. Regjistrat profesionalë janë dokumente publikë, të cilat, në përgjegjësinë e Sekretariatit Teknik, publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe u mundësohet aksesi në to, çdo subjekti publik apo privat.

KREU VI
SANKSIONE DHE DIZPOZITA KALIMTARE

Neni 41

**Sanksione ndaj subjekteve të licencuara**

1. Komisioni merr vendime ndaj individëve dhe shoqërive/studiove të licencuara, duke vendosur masën e heqjes së të drejtës së ushtrimit të aktivitetit të licencuar, tërësisht ose pjesërisht për kategoritë që disponon në licencë, në rastet kur:

a) Konstatohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë Rregullore) të rreme, apo dokumente të pavërteta;

b) Kryen veprimtari pa drejtues teknik/nuk plotëson detyrimet dhe kufizimet, që rrjedhin nga kjo rregullore;

c) Kur drejtuesi teknik largohet nga shoqëria/studio, pa respektuar procedurat e përcaktuara në pikën "e", të neni 25, të kësaj rregulloreje;

ç) Ka propozime të motivuara nga subjekte juridikë publik apo privat, për shkelje të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë.

2. Për çdo rast, nga Sekretariati Teknik paraqitet materiali për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Komisionit, së bashku me raportin e vlerësimit të grupit të ekspertëve, në rastin kur është kërkuar nga Komisioni.

3. Masat që komisioni merr, janë:

a) "Heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 6 muaj", kur vërtetohet, se ka kryer shkelje të përcaktuara në njërën nga rastet e pikës 1, të këtij neni, por jo në mënyrë të përsëritur.

b) "Heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 1 vit", kur vërtetohet se ka kryer shkelje të përcaktuara, në njërën nga rastet e pikës 1, të këtij neni, në mënyrë të përsëritur.

c)"Heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 3 vit", kur vërtetohet se ka kryer shkelje të përcaktuara, në njërën nga rastet e pikës 1, të këtij neni, edhe pasi subjekti ka ezauruar kohën e sanksionit nga një pezullim i mëparshëm.

ç) "Heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për një periudhë 5 vjet" për rastet, kur është konstatuar ushtrim veprimtarie pa disponuar licencë të vlefshme për atë lloj veprimtarie, ose ushtrim aktiviteti brenda afatit të një penalizimi.

4. Për masat e vendosura nga Komisioni, njoftohet brenda një dite, subjekti ndaj të cilit është vendosur masa dhe struktura përgjegjëse për inspektimin në këtë fushë. Për rastet e deklarimeve të rreme, sanksionet ligjore për licencimin shoqërohen edhe me kallëzim në organet kompetente.

Neni 42
**Ankimi**

1. Për çdo vendim të Komisionit, individët apo përfaqësuesit e shoqërive, kanë të drejtën e ankimit tek Ministri i Zhvillimit Urban, brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e njoftimit apo publikimit.

2. Ministri i Zhvillimit Urban, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 15 ditëve kalendarike:

a) Lënien në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni.

b) Kthimin për rishqyrtim, në Komision, të vendimit të marrë.

c) Ndaj vendimit të Ministrit apo vendimit përfundimtar të komisionit, çdo subjekt, ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente administrative, brenda 45 ditëve kalendarike.

Neni 43
**Dispozita kalimtare**

1. Licencat profesionale individuale apo të shoqërive, për studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen të vlefshme brenda një afati kohor 12 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje. Brenda këtij afati, subjektet duhet të bëjnë rinovimin e licencave, me formatin e ri të kategorive, si dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. Pas këtij afati, licencat e parinovuara do të jenë të pavlefshme.

2. Licencat profesionale individuale apo të shoqërive, për mbikëqyrje e kolaudim, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjitha kategoritë e të cilave nuk ndryshojnë emërtim, sipas kësaj rregulloreje, mbeten të vlefshme, pa iu nënshtruar përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

3. Për një periudhë 6 mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, aplikimet për licencimin profesional mund të kryhen edhe nëpërmjet shërbimit postar. Dokumentet për Licencë duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara, në gjuhen shqipe, ose të përkthyera nga përkthyes zyrtarë.

- Kërkesat që pas shqyrtimit rezultojnë të parregullta, nënshkruhen pas motivimit nga pranuesi, dhe njoftohet subjekti aplikues, brenda një dite, për mangësitë, me shkresë zyrtare/ njoftime verbale/postë elektronike/telefon.

- Aplikimet, pasi vijnë pranë Sekretariatit Teknik, nëpërmjet zyrës së arkivës e protokollit, regjistrohen menjëherë në protokollin e aplikimeve, shoqërohen me kartelë dhe ndjekin procedurën e trajtimit, sipas përcaktimeve në këtë rregullore. Në këto raste, së bashku me kopjen e licencës, mbahet në arkivën e Sekretariatit edhe dokumentacioni i plotë i aplikimit respektiv të subjektit.

Pjesë e kësaj rregullore janë Lidhjet bashkëngjitur.

**ANEKS**

| | |
|---|---|
| **Lidhja 1** | **Tarifat e pagesës për marrjen e licencës profesionale** |
| **Lidhja 2** | **Kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim** |
| **Lidhja 3** | **Kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim** |
| **Lidhja 3/1** | **Shpjegime për kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim** |
| **Lidhja 4** | **Kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit** |
| **Lidhja 5** | **Kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim** |
| **Lidhja 6** | **Vetëdeklarimet** |

LIDHJA 1

TARIFA

Për individët dhe personat juridik vendas dhe të huaj që pajisen me Licencë profesionale zbatohen këto tarifa:

| | |
|---|---|
| Licencim individual për herë të parë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Licencim të shoqërisë për herë të parë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Shtesa në kategoritë e licencës individuale | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Rinovim ose dublikatë të licencës individuale | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Zgjatje të afatit/rinovim/dublikatë të licencës së shoqërisë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Ndryshim të përfaqësuesit/përfaqësuesve ligjorë apo teknikë të shoqërisë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Ekuivalentim të licencës profesionale për individë që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Ekuivalentim të licencës profesionale të shoqërive të huaja që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Ndryshim të emërtimit të shoqërisë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |
| Ndryshim të selisë së shoqërisë | 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë |

LIDHJA 2

KATEGORITË NË FUSHAT E STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT NË NDËRTIM

1. PROJEKTIM URBANIST

a) 1. Plane kombëtare sektoriale; 2. Plane të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

b) 1. Plane sektoriale në nivel qarku; 2. Plane sektoriale në nivel bashkie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

c) Plane të detajuara vendore.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

a) Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike.

b) 1. objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. objekte spitalore; terminalet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.

c) Projektim interiere.

ç) Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b) 1.Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.

c) 1.Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

ç) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

d) Objekte civile e turistike prej druri.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

b) Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

ç) Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit.

d) Projektim të sistemeve të furnizimit me gaz.

dh) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

e) Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

ë) Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.)

f) Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.

g) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

a) Diga të mëdha (diga me lartësi mbi 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar mbi 1 milion $m^3$ ose gjatësi kurore dige mbi 500 ml).

b) Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

c) Ujësjellës kanalizime urbane - rurale.

ç) Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga te vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha)– damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

d) Vepra të trajtimit të ujit. Kjo kategori jepet vetëm për personat juridik (shoqëri/studio)

dh) Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi– shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

e) Vepra naftësjellës – gazsjellës – vajsjellës etj.

ë) Vepra hidroteknike –kulla ekuilibri–porte-pontile.

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b)Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

c) Autostrada

ç) Aeroporte – helioporte - hidroporte.

d) Hekurudha – degëzime hekurudhore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

a) Ura dhe vepra arti të vogla deri me 10 m.

b) Ura dhe vepra arti mbi 10 m.

c) Ura/viadukte me hapësira të mëdha drite, ura të varura, ura me sisteme të pacaktuar statikisht dhe sisteme te tjera speciale.

ç)Ura metalike.

d) Tunele rrugore - hekurudhore.

8. PROJEKTUES GJEODET

a) Rivelime inxhinierike.

b) Rilevime inxhinierike kadastrale.

c) Sisteme GIS.

ç) Bazamente gjeodezike.

d) Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

9. STUDIM GJEOLLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

a) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

b) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.

c) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.

ç) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

d) Studime e projektime hidrogjeologjike.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

a) Centrale hidraulike (elektrike, primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

b) Centrale termike (primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

c) Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era, etj.

ç) Nënstacione elektrikë, primar sekondar – linja të tensionit të lartë.

d) Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

a) Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

b) Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

c) Sinjalistikë jondriçuese në aeroporte dhe heliporte.

ç) Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridik).

a) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

c) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj.

ç) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse si: hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.

d) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

dh) Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonime sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).

13.STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VENDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA (URBANE). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

14. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT TË IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

LIDHJA 3

KATEGORITË NË FUSHAT E MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP–1 Punime gërmimi në tokë.

NP–2 Ndërtime civile dhe industriale.

NP–3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

NP–4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP–5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP–6 a Diga të çdo lloj madhësie. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

NP–6 b Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion $m^3$ ose gjatësi kurore dige deri 500 ml).

NP-6 c. Tunele hidroteknike.

NP–7 a. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

NP–7 b. Vepra naftësjellës-gazsjellës-vajsjellës.

NP–8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.

NP–9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP–10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

NP–11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

NP–12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.

NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

NS-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

NS-6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

NS-7 Barrierra dhe mbrojtje rrugore.

NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme.

NS-8 b. Struktura metalike

NS-8 c. Struktura druri.

NS-9 Punime strukturore speciale.

NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.

NS-11. Punime mbi shina dhe traversa.

NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

NS-15 Pastrimi i ujërave detarë, liqenorë dhe lumorë.

NS-16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

NS-17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

NS-18 Punime topogjeodezike.

NS-19 Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë.

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

NS-21 Impiante të trajtimit të ujërave të zeza. Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

LIDHJA 3/1

SHPJEGIME PËR KATEGORITË NË FUSHAT E MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

**NP–1 - Punime gërmimi në tokë**

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

**NP–2 - Ndërtime civile dhe industriale**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

**N.P. 3 - Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada**

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

**N.P. 4 - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale**

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë,

autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

**N.P. 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

**NP–6 a Diga të çdo lloj madhësie. Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio)**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

**NP–6 b Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m$^3$ ose gjatësi kurore dige deri 500 ml)**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

**NP-6 c. Tunele hidroteknike**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për qarkullimin e ujit për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes.

**NP–7 a. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

**NP–7 b. Vepra naftësjellës-gazsjellës-vajsjellës**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet, që janë të nevojshme për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve.

**N.P. 8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që i përkasin terminaleve "ujore" ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujorë, ujësjellësit nënujorë,

vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura.

**N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale, si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

**N.P.10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike**

Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë.

Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet.

**N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

**N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

I. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

**N.S -1 Punime për prishjen e ndërtimeve**

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

**N.S-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.**

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)**

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin,

bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

**N.S - 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut**

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.

**N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese**

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

**N.S - 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore**

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi i elementeve si guard rail, New Jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme.

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

NS-8 b. Struktura metalike.

Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

NS-8 c. Struktura druri.

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë druri të drejtë të trajtuar përpara.

**N.S- 9 Punime strukturore speciale.**

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratori nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.

**N.S- 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dyshemeve) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale.

**N.S - 11 Punime në shina dhe traversa**

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike, ristrukturimi i binarëve për çfarëdo lloj hekurudhe, metroje, tramvaji, si edhe sistemin e frenimit dhe automatizimin e stacioneve të mallrave.

**N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit**

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

**N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni**

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV**

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

**N.S.- 15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore**

Konsiderohet pastrimi me mjete teknike speciale të veçantë të çfarëdo lloj uji dhe të transportit të materialeve që dalin nga pastrimi i tij në vende të caktuara me akte normative.

**N.S.- 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.** Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

**N.S - 17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.** Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Konsiderohet zbatimi dhe mirëmbajtja e zakonshme ose e jashtëzakonshme, e impiantit të djegies së mbetjeve e lidhur me sistemin e trajtimit të tymrave, e ripërdorimit të materialeve përfshirë makineritë e seleksionimit, kompostimin dhe prodhimin e derivateve të djegshme nga mbetjet, e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

**N.S - 18 Punime topogjeodezike**

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

**N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë**

Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

**N.S- 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë**

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.

**NS-21 Impiante të trajtimit të ujërave të zeza**.

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujërave të zeza që duhen trajtuar, kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

LIDHJA 4

KUSHTE DHE KRITERE SPECIFIKE QË KRYESISHT DUHEN PLOTËSUAR PËR TË FITUAR KATEGORITË NË FUSHAT E STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT

1. PROJEKTUES URBANIST

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 1.a.** - Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Urbanist/Planifikues Territorial/Arkitekt diplomuar para vitit 1988, dhe
- Arkitekt, dhe
- Inxhinier ndërtimi i profilit transport, dhe
- Inxhinier Mjedisi dhe
- Inxhinier Gjeolog/Hidrogjeolog dhe
- Inxhinier Gjeodet.

**Kategoria 1.b.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Urbanist/Planifikues Territorial/Arkitekt diplomuar para vitit 1988, dhe
- Arkitekt, dhe
- Inxhinier ndërtimi i profilit transport, dhe
- Inxhinier Mjedisi, dhe
- Inxhinier Gjeolog/Hidrogjeolog dhe
- Inxhinier Gjeodet.

**Kategoria 1.c.** - Individë, me diplomë në profilet Urbanist/Planifikim Territorial/Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale të përfituar para vitit 1971/Arkitekturë.

2. Vite eksperiencë, në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë, sipas kategorive:

**Kategoria 1.a,** – Urbanisti/Planifikuesi territorial/Arkitekti diplomuar para vitit 1988 - Individë që kanë disponuar më parë licencë profesionale individuale për këtë kategori, me eksperiencë profesionale mbi 15 vjet, ndërsa Arkitekti, Inxhinieri i Ndërtimit i profilit Transport, Inxhinieri i Mjedisit, Inxhinieri Gjeolog/ Hidrogjelog dhe Inxhinieri Gjeodet, të plotësojnë të paktën kushtin e përgjithshëm të eksperiencës së drejtuesit teknik (prej 5 vjet/3 vjet me mesatare note mbi 9).

**Kategoria 1.b** – Urbanisti/Planifikuesi territorial/Arkitekti diplomuar para vitit 1988 - Individë që kanë disponuar më parë licencë profesionale individuale për këtë kategori, me eksperiencë profesionale mbi 15 vjet, ndërsa Arkitekti, Inxhinieri i Ndërtimit profili Transport, Inxhinieri i Mjedisit, Inxhinieri Gjeolog/Hidrogjeolog dhe Inxhinieri Gjeodet, të plotësojnë të paktën kushtin e përgjithshëm të eksperiencës së drejtuesit teknik (prej 5 vjet/3 vjet me mesatare note mbi 9).

**Kategoria 1.c**_- Eksperiencë mbi 2 vjet.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 2.a** - Individë, me diplomë në profilet Arkitekt/Urbanist/Planifikues territorial/ Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 2.b** - Individë, me diplomë në profilin Arkitekt.

**Kategoria 2.c** - Individë, me diplomë në profilin Arkitekt.

**Kategoria 2.ç** - Individë, me diplomë në profilin Arkitekt/Urbanist/Planifikues Territorial/ profilin Industri Druri/profili Agromjedis & Ekologji/Hiortikulture & Arkitekture Peizazhi.

2. Vite eksperiencë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 2.a**_- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 2.b** – 1. Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet. 2. Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet. 3. Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

**Kategoria 2.c**- Eksperiencë profesionale mbi 2 vjet.

**Kategoria 2.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 2 vjet.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 3.a**– Individë me diplomë në profilet e Inxhinierëve të Ndërtimit.

**Kategoria 3.b** – 1. Individë me diplomë master shkencor (jo master profesional), ose diplomë të integruar të nivelit të dytë, në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profilin Hidroteknik). 2. Individë me diplomë master shkencor (jo master profesional) në profilin Strukturist, diploma të integruara të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profilin Hidroteknik).

**Kategoria 3.c** – 1. Individë me diplomë master shkencor (jo master profesional) në profilin Strukturist ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profilin Hidroteknik). 2. Individë me diplomë master shkencor (jo master profesional) në profilin Gjeoteknik, ose diploma të integruara në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profili Hidroteknik).

**Kategoria 3.ç** – 1. Individë me diplomë master shkencor (jo master profesional) në profilin Strukturist ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profilin Hidroteknik).

**Kategoria 3.d** –Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profilin Hidroteknik)/profilin Industri Druri.

2. Vite eksperiencë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 3.a**_- Eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

**Kategoria 3.b** –Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 3.c**- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 3.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 3.d**- Eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 4.a** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit/ Gjeoteknik)/profili Inxhinier Mjedisi/ Inxhinier Mekanik i profilit Energjetikë/ Termoteknik/ Impiante/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 4.b** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit, profili Termoteknikë/profili Inxhinier Mjedisi për Energjetikë/profilet e Inxhinierit Mekanik për Termoteknikë/Industri/Impiante/Energjetikë.

**Kategoria 4.c** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektrike.

**Kategoria 4.ç** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektronike për Telekomunikacion.

**Kategoria 4.d** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit profili Termoteknikë/profili Inxhinier Mjedisi për Energjetikë/profilet e Inxhinierit Mekanik për Termoteknikë/Industri/Impiante/Energjetikë.

**Kategoria 4.dh** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit/ Gjeoteknik)/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971/Inxhinier Hidroteknik/profili Inxhinier Mjedisi/profilet e Inxhinierit Mekanik për Termoteknikë/Industri/Impiante/Energjetikë/profilet e inxhinierit Elektrik për automatizim apo industri.

**Kategoria 4.e** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektronike/Inxhinierit Mekatronik/Inxhinieri Mekanik për Impiante.

**Kategoria 4.ë** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik për Industri/ Impiante dhe inxhinierit Mekatronik.

**Kategoria 4.f** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektrike.

**Kategoria 4.g** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektronike.

2. Vite eksperiencë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

Kategoria 4.a - Eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

Kategoria 4.b –Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

Kategoria 4.c - Eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

Kategoria 4.ç - Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 4.d - Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 4.dh- Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 4.e - Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 4.ë - Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 4.f - Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 4.g - Eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 5.a** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/ profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 5.b** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/ profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 5.c** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/ profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 5.ç** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/ profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 5d.** - Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Mjedisit të trajtimit të Ujërave të Inxhinierit të Ndërtimit/ Kimist Teknolog të diplomuar përpara vitit 1985.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet në profilin Hidroteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 5.dh** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/ profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 5.e** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierit Mekanik për Termoteknikë/ Industri/Impiante/Energjetikë.

**Kategoria 5.ë** - Individë me diplomë master shkencor (jo master profesional) në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: profili Strukturist/profili Gjeoteknik ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierëve të Ndërtimit.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 5.a** - Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

**Kategoria 5.b** –Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 5.c**_- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 5.ç**_- Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 5.d** – Drejtuesit teknik të kenë eksperiencë profesionale mbi 10 vjet (përjashtuar Kimisti Teknolog dhe Inxhinieri i Ndërtimit Qytetare Industriale për të cilët kushtet përcaktohen më lart).

**Kategoria 5.dh** - Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 5.e** - Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 5.ë** - Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

6. PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 6.a** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin Hidroteknik).

**Kategoria 6.b** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: në Infrastrukturë të Transportit dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi po në këto profile/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 6.c** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional) në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: në Infrastrukturë të Transportit dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi po në këto profile/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 6.ç** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional) në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: në Infrastrukturë të Transportit dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi po në këto profile/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 6.d** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional) në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit në Infrastrukturë të Transporti dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi po në këtë profil/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 6.a**_- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 6.b** –Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 6.c**- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 6.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

**Kategoria 6.d**- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

7. PROJEKTUES URA DHE VEPRA ARTI

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 7.a** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Gjeoteknik), Inxhnier Hidroteknik.

**Kategoria 7.b** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik/ Gjeoteknik), dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profili Hidroteknik).

**Kategoria 7.c** –Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Strukturist ose Infrastrukturë e Transportit, dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profili Hidroteknik/Gjeoteknik).

**Kategoria 7.ç** –Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Strukturist ose Infrastrukturë e Transportit dhe profilin konstruksion të Inxhinierit Mekanik, dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profili Hidroteknik/Gjeoteknik) dhe profilin konstruksion të Inxhinierit Mekanik.

**Kategoria 7.d** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik), dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi, përjashtuar profili Hidroteknik.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 7.a** - Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 7.b** –Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 7.c** - Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 7.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

**Kategoria 7.d** - Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

8. PROJEKTUES GJEODET

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 8.a** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/ Inxhinier Markshajder/Inxhinier Gjeomatik.

**Kategoria 8.b** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/ Inxhinier Gjeomatik/individë të cilët, kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në degën Topografi/Gjeodezi ose pas një programi arsimor, zotërojnë titullin "Teknik Topograf".

**Kategoria 8.c** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Gjeomatik/ Inxhinier Gjeoinformatik.

**Kategoria 8.ç** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf.

**Kategoria 8.d** – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 8.a**– eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

**Kategoria 8.b**– 1) Për Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/ Inxhinier Gjeomatik/eksperiencë profesionale mbi 3 vjet. 2) Për individë me arsim të mesëm profesional të specialitetit topograf, eksperiencë profesionale mbi 15 vjet nga përfundimi i arsimit të mesëm apo nga momenti i marrjes së titullit "teknik topograf".

**Kategoria 8.c**- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 8.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 8.d** –Eksperimencë profesionale mbi 10 vjet.

9. STUDIUES - PROJEKTUES GJEO-LLOGO-INXHINIERIK

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 9.a** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogjeologji/ Gjeoteknikë.

**Kategoria 9.b** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogjeologji/ Gjeoteknikë.

**Kategoria 9.c** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogjeologji/ Gjeoteknikë.

**Kategoria 9.ç** – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogjeologji/ Gjeoteknikë.

**Kategoria 9d.** Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji Inxhinierike/ Hidrogjeologji/ Gjeoteknikë.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 9.a**- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 9.b** –Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 9.c**- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 9.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

**Kategoria 9.d**- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 10.a.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet:

- Inxhinier Elektrik, dhe

- Inxhinier Mekanik për Energjetikë/Impiante dhe

- Inxhinier ndërtimi të profilit Hidroteknik ose profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**Kategoria 10.b.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Inxhinier Elektrik,

- Inxhinier Mekanik për Energjetikë/Impiante ose Inxhinier Mjedisi profili Energjetikë.

**Kategoria 10.c.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Elektrik në Energjetikë, diplomë në profilin Mjedis Energjetikë, diplomë në profilin Mekanik për Energjetikë.

**Kategoria 10.ç.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrik.

**Kategoria 10.d.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrik.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 10.a**– Drejtuesit teknikë të specifikuar duhet të kenë (secili) eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

**Kategoria 10.b** – Drejtuesit teknikë të specifikuar duhet të kenë (secili) eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 10.c**- Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 10.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 10.d**- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 11.a.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit në Infrastrukturë e Transportit/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.

**Kategoria 11.b.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit në Infrastrukturë

e Transportit/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.

**Kategoria 11.c.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit në Infrastrukturë e Transportit/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.

**Kategoria 11.ç.** - Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektrike/ Elektronike/ Mekatronike ose në profilin e Inxhinierit Mekanikë Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.

2. Vite eksperiencë në subjekte publike dhe jopublike projektuese, në institucione të arsimit të lartë:

**Kategoria 11.a**- Eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

**Kategoria 11.b**- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 11.c**- Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

**Kategoria 11.ç**- Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridik).

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 12.a.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio) që kanë drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Gjeofizikes/Gjeoteknikës ose,
- Individë që kanë kryer programe universitare të nivelit master/doktoraturë në fushën e sizmikës ose,
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike ose Hidrogjeologji,
- të cilët duhet të plotësojnë, të paktën, njërin nga kushtet në vijim:
- të kenë kryer studime në fushën e sizmologjisë inxhinierike apo fushën e vlerësimit gjeoteknik të trojeve për qëllime të rajonizimit sizmik të tyre.
- të kenë qenë ose të jenë punonjës mësimor-shkencor në institucionet akademike apo kërkimore dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmologjisë inxhinierike për rrezikun sizmik me nivel kombëtar apo rajonal.
- të jenë titullarë lënde për fushat e sizmologjisë inxhinierike, gjeoteknikës dhe vlerësimit të riskut natyror.

**Kategoria 12.b.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio) që kanë drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Gjeofizikës; ose
- Individë që kanë kryer programe universitare të nivelit master/doktoraturë në fushën e sizmikes; ose
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike ose Hidrogjeologji;
- të cilët duhet të plotësojnë, të paktën, njërin nga kushtet në vijim:
- të kenë kryer studime në fushën e sizmologjisë inxhinierike apo fushën e vlerësimit gjeoteknik të trojeve për qëllime të rajonizimit sizmik të tyre.
- të kenë qenë ose të jenë punonjës mësimor-shkencor në institucionet akademike apo kërkimore dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmologjisë inxinierike për rrezikun sizmik me nivel kombëtar apo rajonal.
- të jenë titullarë lënde për fushat e sizmologjisë inxhinierike, gjeoteknikës dhe vlerësimit të riskut natyror.

**Kategoria 12.c.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio) që kanë drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Gjeofizikës ose,
- Individë që kanë kryer programe universitare të nivelit master/doktoraturë në fushën e sizmikës ose,
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike ose Hidrogjeologji,

të cilët duhet të plotësojnë, të paktën, njërin nga kushtet në vijim:

- të kenë kryer studime në fushën e sizmologjisë inxhinierike apo fushën e vlerësimit gjeoteknik të trojeve për qëllime të rajonizimit sizmik të tyre.

- të kenë qenë ose të jenë punonjës mësimor-shkencor në institucionet akademike apo kërkimore dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmologjisë inxinierike për rrezikun sizmik me nivel kombëtar apo rajonal.

- të jenë titullarë lënde për fushat e sizmologjisë inxhinierike, gjeoteknikës dhe vlerësimit të riskut natyror.

**Kategoria 12.ç.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio) që kanë drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Gjeofizikës ose,

- Individë që kanë kryer programe universitare të nivelit master/doktoraturë në fushën e sizmikës ose,

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike ose Hidrogjeologji,

të cilët duhet të plotësojnë, të paktën, njërin nga kushtet në vijim:

- të kenë kryer studime në fushën e sizmologjisë inxhinierike apo fushën e vlerësimit gjeoteknik të trojeve për qëllime të rajonizimit sizmik të tyre.

- të kenë qenë ose të jenë punonjës mësimor-shkencor në institucionet akademike apo kërkimore dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmologjisë inxinierike për rrezikun sizmik me nivel kombëtar apo rajonal.

- të jenë titullarë lënde për fushat e sizmologjisë inxhinierike, gjeoteknikës dhe vlerësimit të riskut natyror.

**Kategoria 12.d.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio) që kanë drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Gjeofizikës ose,

- Individë që kanë kryer programe universitare të nivelit master/doktoraturë në fushën e sizmikës ose,

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike ose Hidrogjeologji,

të cilët duhet të plotësojnë ,të paktën, njërin nga kushtet në vijim:

- të kenë kryer studime në fushën e sizmologjisë inxhinierike apo fushën e vlerësimit gjeoteknik të trojeve për qëllime të rajonizimit sizmik të tyre.

- të kenë qenë ose të jenë punonjës mësimor-shkencor në institucionet akademike apo kërkimore dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmologjisë inxinierike për rrezikun sizmik me nivel kombëtar apo rajonal.

- të jenë titullarë lënde për fushat e sizmologjisë inxhinierike, gjeoteknikës dhe vlerësimit të riskut natyror.

**Kategoria 12.dh.** - Vetëm për persona juridik (shoqëri/studio), që kanë drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Gjeofizikës ose,

- Individë që kanë kryer programe universitare të nivelit master/doktoraturë në fushën e sizmikës ose,

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike ose Hidrogjeologji,

të cilët duhet të plotësojnë, të paktën, njërin nga kushtet në vijim:

- të kenë kryer studime në fushën e sizmologjisë inxhinierike apo fushën e vlerësimit gjeoteknik të trojeve për qëllime të rajonizimit sizmik të tyre.

- të kenë qenë ose të jenë punonjës mësimor-shkencor në institucionet akademike apo kërkimore dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmologjisë inxinierike për rrezikun sizmik me nivel kombëtar apo rajonal.

- të jenë titullarë lënde për fushat e sizmologjisë inxhinierike, gjeoteknikës dhe vlerësimit të riskut natyror.

2. Vite eksperiencë në institucione projektuese publike, studio private ose institucione të arsimit të lartë sipas kategorive duhet të jetë:

**Kategoria 12.a** - Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

**Kategoria 12.b** - Eksperiencë profesionale mbi 8 vjet.

**Kategoria 12.c** - Eksperiencë profesionale mbi 8 vjet.

**Kategoria 12.ç** - Eksperiencë profesionale mbi 8 vjet.

**Kategoria 12.d** - Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

**Kategoria 12.dh** - Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

13. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VENDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA (URBANE) (vetëm për persona juridik , shoqëri/studio).

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 13.** - Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Mjedisit të Inxhinierit të Ndërtimit/Kimist Teknolog të diplomuar përpara vitit 1985.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet në profilin Hidroteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

2. Vite eksperiencë në subjekte publike dhe jopublike projektuese, në institucione të arsimit të lartë:

Eksperienca sipas kushte të përgjithshme të drejtuesit teknik (prej 5 vjet/3 vjet me mesatare note mbi 9).

14. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT TË IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA (vetëm për persona juridik, shoqëri studio).

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

**Kategoria 14.** - Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Mjedisit të Inxhinierit të Ndërtimit/Kimist Teknolog të diplomuar përpara vitit 1985.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: në profilin Hidroteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë Inxhinier Mekanik të profilit Impiante.

2. Vite eksperiencë në subjekte publike dhe jopublike projektuese, në institucione të arsimit të lartë:

Eksperienca 7 vjet për secilin drejtues teknik (përjashtuar Kimistin Teknolog dhe Inxhinierin për Ndërtime Qytetare Industriale të cilët kanë kushtet e mësipërme).

LIDHJA 5

KUSHTE DHE KRITERE SPECIFIKE QË KRYESISHT DUHEN PLOTËSUAR PËR TË FITUAR KATEGORITË NË FUSHAT E MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

**NP–1. Punime gërmimi në tokë**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit.

**NP–2. Ndërtime civile dhe industriale**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.

**NP–3. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.

**NP–4. Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik).

**NP–5. Punime nëntokësore, ura e vepra arti**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Gjeoteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971, (përjashtuar profili Hidroteknik).

**NP–6 a. Diga të çdo lloj madhësie**

Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971, dhe

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Gjeoteknik të Inxhinierit të Ndërtimit.

**NP–6 b. Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m$^3$ ose gjatësi kurore dige deri 500 ml)**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**NP-6 c. Tunele hidroteknike**

Vetëm për personat juridik (shoqëri/studio), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë:

- Individë me diplomë master (jo master profesional) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit, dhe
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Gjeoteknik të Inxhinierit të Ndërtimit

**NP–7 a. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit.

**NP–7 b. Gazsjellës e vajsjellës**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik për impiante/ Energjetikë/ industri/ termoteknikë.

**NP–8. Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë**

Individë me diplomë master në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit Inxhinierit: profili Strukturist/profili Gjeoteknik ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierëve të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës e Transportit dhe profilin Hidroteknik).

**NP–9. Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Hidroteknik të Inxhinierit të Ndërtimit/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

**NP–10. Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike. Vetëm për persona juridik (shoqëri)**

Vetëm për persona juridik (shoqëri), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Inxhinier Elektrik, dhe
- Inxhinier Mekanik për Energjetikë/Impiante.

**NP–11. Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrik.

**NP–12. Punime të inxhinierisë së mjedisit**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Mjedisit të Inxhinierit të Ndërtimit/diplomë të degës mjedis të Universitetit Bujqësor.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

**NS-1. Punime për prishjen e ndërtimeve**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit.

**NS-2. Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit dhe profilet e inxhinierit Mekanik në Impiante/Energjetikë/Termoteknikë.

**NS-3. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik.

**NS-4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.

**NS-5. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrik/Elektronik.

**NS-6. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Infrastrukturë e Transportit/ Inxhinier Ndërtimi i diplomuar në degën Inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit

1971/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.

**NS-7. Barrierra dhe mbrojtje rrugore**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Infrastrukturë e Transportit/ Inxhinier Ndërtimi i diplomuar në degën Inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit 1971/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.

**NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik).

**NS-8 b. Struktura metalike**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik)/në profilin e Inxhinierit Mekanik në industri/konstruksion.

**NS-8 c. Struktura druri**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt/profilin Industri Druri.

**NS-9. Punime strukturorë speciale**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Trasportit dhe profilin Hidroteknik).

**NS-10. Shtresa dhe mbistruktura speciale.**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profilin Hidroteknik).

**NS-11. Punime mbi shina dhe traversa.**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Infrastrukturë e Transportit/ Inxhinier Ndërtimi i diplomuar në degën Inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit 1971/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit.

**NS-12. Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik në Impiante/ Energjetikë /Termoteknikë /Industri ose profili Mjedis Energjetikë, të Inxhinierisë së Ndërtimit.

**NS-13. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektronik për Telekomunikacion.

**NS-14. Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrik/Elektronik.

**NS-15. Pastrimi i ujërave detarë, liqenorë dhe lumorë**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Mjedisit Trajtim Ujëra/Kimist teknolog.

**NS-16. Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij**

Vetëm për persona juridik (shoqëri), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e trajtimit të ujit të Mjedisit të Inxhinierit të Ndërtimit/Kimist Teknolog të diplomuar përpara vitit 1985.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet në profilin Hidroteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

Në lidhje me vitet e eksperiencës profesionale do të zbatohet kriteri i përgjithshëm prej 15 vitesh (përjashtuar rastin e Kimistit Teknolog dhe Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale të cilët kanë kriteret e përmendura më lart).

**NS-17. Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane**

Vetëm për persona juridik (shoqëri), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Mjedisit të Inxhinierit të Ndërtimit/Kimist Teknolog të diplomuar përpara vitit 1985.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet në profilin Hidroteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.

Në lidhje me vitet e eksperiencës profesionale do të zbatohet kriteri i përgjithshëm prej 15 vitesh (përjashtuar rastin e Kimistit Teknolog dhe Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale të cilët kanë kriteret e përmendura më lart).

**NS-18 Punime topogjeodezike**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/Inxhinier Markshajder/Inxhinier Gjeomatik.

**NS-19. Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Ndërtimi në Infrastrukturën e Transportit/Mjedis Energjetikë/Arkitekt.

**NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë**

Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji Inxhinierike/Hidrogjeologji/Gjeoteknikë.

**NS-21 Impiante të trajtimit të Ujërave të zeza.** Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Vetëm për persona juridik (shoqëri), që kanë njëkohësisht drejtues teknikë, individë, me diplomë në profilet:

- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Mjedisit të Inxhinierit të Ndërtimit/Kimist Teknolog të diplomuar përpara vitit 1985.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Hidroteknik/profili Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale me diplomë të përfituar para vitit 1971.
- Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë të Inxhinierit Mekanik të profilit Impiante

Në lidhje me vitet e eksperiencës profesionale do të zbatohet kriteri i përgjithshëm prej 15 vitesh (përjashtuar rastin e Kimistit Teknolog dhe Inxhinier për Ndërtime Qytetare Industriale të cilët kanë kriteret e përmendura më lart).

LIDHJA NR. 6

VETDEKLARIMET

6/1.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit ___________ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _______ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

“Deklaroj se njoh e do të zbatoj në veprimtarinë time si individ, Kushtet Teknike të Projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit”

6/2.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohemi (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit ___________ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _______ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

“Deklaroj se njoh e do të zbatoj në veprimtarinë time si individ, Kushtet Teknike të Projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit”

“ Gjithashtu deklaroj se nuk jam i punësuar në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e zbatimit në ndërtim”.

6/3.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohemi (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit ___________ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam

në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _______ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

"Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik. (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore ___________ (shoqëruar me motivin e penalizimit).

6/4.

"Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohemi (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit ___________ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _______ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

"Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik. (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore ___________ (shoqëruar me motivin e penalizimit).

" Gjithashtu deklaroj se nuk jam i punësuar në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e zbatimit në ndërtim".

6/5.

"Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohemi (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit ___________ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _______ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

" Gjithashtu deklaroj se; nuk jam i punësuar në rolin e drejtuesit teknik në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit".

" Gjithashtu deklaroj se; nuk jam në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil".

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë